

Roli i arsimit për të rriturit tek qytetaria aktive

Bashkohuni me komunitetin e EPALE me më shumë se 26 000 specialistë të të nxënit për të rritur për të vlerësuar, komentuar dhe kontribuar!

Të dashur kolegë të EPALE,



Në muajin maj fokusi tematik i EPALE ishte tek qytetaria aktive dhe tek rëndësia e edukimit për qytetarinë. Ekipet kombëtare të EPALE mbledhën një sërë artikujsh interesantë, rastesh studimore dhe burimesh në lidhje me këtë temë. Shikoni [faqen e posaçme për fokusin e EPALE](#) dhe mos e humbisni një [përmbledhje me disa nga blogjet e reja](#), të përgatitur nga Koordinatori Tematik Simon Broek dhe të publikuar në muajin maj.

Postime në formë blogu

[Podcast-i i EPALE: Cili është roli i të nxënit për të rritur tek qytetaria aktive?](#)

Koordinatorët Tematikë të EPALE [Andrew McCoshan](#), [David Mallows](#), [Gina Ebner](#) dhe [Simon Broek](#) u mbledhën së bashku për të diskutuar rolin dhe sfidat e të nxënimit për të rriturit në lidhje me qytetarinë aktive.

Promovimi i tolerancës dhe mirëkuptimit - roli unik i arsimit për të rriturit

Dy vite pas Deklaratës së Parisit për qytetarinë dhe të drejtat e njeriut, Koordinatori Tematik i EPALE [Andrew McCoshan](#) analizoi rolin që mund të luajë arsimi për të rriturit në promovimin e vlerave të lirisë, pluralizmit dhe mos-diskriminimit.

Të bëhesh qytetar aktiv: Si mund t'i bëjmë modelet tona të arsimit për të rriturit më gjithëpërfshirëse?

Prof. Pirkko Pitkänen dhe Dr. Amalia Sabiescu ndanë mendimet e tyre në lidhje me projektin EduMAP dhe me mënyrën sesi arsimi për të rriturit mund të ndihmojë për integrimin e të rriturve vulnerabël.

Lajme nga mbarë Europa



Muaji maj ishte një muaj i ngjeshur me aktivitete për sektorin e të nxënimit për të rriturit në Europë:

- Në Belgjikë [Qendra Flamande Mbështetëse për Arsimin e të Rriturve](#) organizoi një anketë për të mbledhur ide në lidhje me promovimin e shkrim-

këndimit në radhët e të rriturve me nivele të ulëta të këtyre aftësive në Flanders (në gjuhën flamande).

- Ndërkohë në Republikën Çeke **qeveria ka filluar të planifikojë rritjen e shpenzimeve për arsimin** në përputhje me zhvillimet e planifikuara (në gjuhën çeke).
- **Edhe sektori i arsimit në Malin e Zi i është nënshtruar ndryshimeve**, ndërkohë që Dhoma e Ekonomisë dhe Ministria e Arsimit organizuan një tryezë të rrumbullakët për ndryshimet në Ligjin për Arsimin (në gjuhën malazeze).

Bashkohuni tani!

Mos harroni të regjistroheni në EPALÉ për të qenë në gjendje që të ndani mendimet tuaja në këto postime. [Bashkohuni tani](#) dhe bëhuni pjesë e komunitetit të përbërë nga më shumë se 26 000 specialistë të të nxënimit për të rriturit.